



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2675/ 4 prot.

Datë 21.11.2023

**V E N D I M**  
**Nr.1200/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.11.2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-79555-09-11-2023 me objekt “Shërbim për rimbushjen dhe kolaudimin e pajisjeve kundër zjarrit”, (marrëveshje kuadër), me fond limit 7,497,514 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.09-2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri”SHPK me NIPT L62102007V dhe adresë “Gurten” sh.p.k., Rruga e Kavajës, nr.116 Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.  
Adresa: Rruga “5 Maji”, God.17, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.09.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79555-09-11-2023, me objekt: “Shërbim për rimbushjen dhe kolaudimin e pajisjeve kundër zjarrit”, me fond limit 7,497,514 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Objekteve Publike Tirane.

II.2. Në datë 22.09.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 02.10.2023 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “i- Fire” SHPK	5.338.238	skualifikuar
2. “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri “SHPK	6.890.000	kualifikuar
3. “VICTORIA -AL” SHPK	7 026 920	kualifikuar

II.4. Nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, operatorit ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri “SHPK, si operator i renditur i pari në procedurën e prokurimit objekt ankimi, në datën 02.10.2023 i është kërkuar të paraqesi pranë autoritetit kontraktor dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h” “i”, “j”, të pikës 2, të nenit 26, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

II.5. Në datën 11.10.2023, KVO-ja e autoritetit kontraktor ka mbajtur procesverbalin për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentave të operatorit ekonomik të kualifikuar i pari “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK. Në përfundim të shqyrtimit të këtij dokumentacioni KVO mori vendimin për skualifikimin e operatorit ekonomik” Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK.

II.6. Në datën 11.10.2023, autoriteti kontraktor ka kryer në sistemin e prokurimeve elektronike rivlerësim për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, nga ku rezulton:

1. “i- Fire” SHPK	5.338.238	skualifikuar
2. “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri “SHPK	6.890.000	skualifikuar
3. “VICTORIA -AL” SHPK	7 026 920	kualifikuar

II.7. Në datën 25.10.2023, autoriteti kontraktor ka kryer Publikim Njoftim Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku operatori ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK rezulton i skualifikuar me arsyet si më poshtë: **1.** Nuk plotëson pikën 2.3.8 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 8 pasi nuk ka paraqitur skedat teknike për produktet Shkumë AFFF 916 (6%) dhe Dioksid karboni (CO<sub>2</sub>). **2.** Nuk plotëson kërkesat e Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit Pika 1 Paragrafi 2, pasi skeda teknike produktit pluhur ABC (40%) është paraqitur në gjuhë të huaj e papërkthyer. **3.** Nuk plotëson pikën 2.3.6 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 8 pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin për kolaudimin e automjetit me targë AB904DB. **4.** Nuk plotëson pikën 2.1.4 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 8 pasi nuk ka paraqitur

*dokumentacionin provues të akreditimit për entin çertifikues që ka lëshuar çertifikatat ISO 9001 dhe ISO 45001."*

II.8. Në datën 31.10.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëherazi pranë autoritetit kontraktor është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3554 dhe me nr. 2675 prot., datë 01.11.2023 i operatorit ekonomik "Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri" SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi e më konkretisht : " [...]

*1. Referuar pikes 1. Nuk plotëson pikën 2.3.8 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 8 pasi nuk ka paraqitur skedat teknike për produktet Shkumë AFFF 916 (6%) dhe Dioksid karboni (CO2)." Shoqeria jone sqaron se:*

*Bazuar ne DST, pika 2.3.8 tek Kriteret e Vecanta te Kualifikimit eshte si me poshte vijon:*

*"2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/fragmente të katalogut ose skedat teknike të publikuara nën autoritetin e prodhuesit për produktet: Pluhur ABC 40%, Shkumë AFFF 916 (6%) dhe Dioksid Karboni (CO2), që do të përdoren në shërbimet që do të kryhen sipas objektit të prokurimit. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pajisjet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit."*

*Ne asnje moment nuk cilesohet qe katalogjet apo skedat teknike te jene ne gjuhen shqipe te perkthyer, pavaresisht se nga ana jone jane sjelle ne gjuhen shqipe vetem ato pjese te katalogut ku pershkruhen qarte specifikimet teknike.*

*Ne kriter pershkruhet qarte se operatori ekonomik do te duhet te dorezoje ose katalog te produktit ose skedat teknike. Shoqeria jone ka dorezuar katalogjet me specifikimet teknike dhe kurresesi nuk duhej skualifikuar per skedat teknike lidhur me produktet. Dokumentacioni i dorezuar prej nesh eshte lehtesisht i verifikueshem sa i takon cdo specifikimi teknik te kerkuar ne DST dhe autoriteti kontraktor e ka patur shume te thjeshte te gjykoje nese malli i ofruar prej nesh i ploteson kerkesat teknike te percaktuara ne dokumentat e tenderit.*

*Sa me siper arsya e skualifikimit lidhur me kete kriter nuk qendron.*

*2. Referuar pikes 2. "Nuk plotëson kërkesat e Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit Pika 1 Paragrafi 2, pasi skeda teknike produktit pluhur ABC (40%) është paraqitur në gjuhë të huaj e papërkthyer. "Shoqeria jone sqaron se:*

*Ne asnje moment nuk cilesohet qe katalogjet apo skedat teknike te jene ne gjuhen shqipe te perkthyer. pavaresisht se nga ana jone jane sjelle ne gjuhen shqipe vetem ato pjese te katalogut ku pershkruhen qarte specifikimet teknike. Pas fazes se mbylljes se tenderit autoriteti kontraktor*

*nuk mund të ndryshojë kriteret dhe nuk mund të kerkojë dokumentacion jashtë kriterëve të përcaktuara prej tij.*

*Sa me sipër arsya e skualifikimit lidhur me këto kriter nuk qendron.*

**3. Referuar pikës 3** "Nuk plotëson pikën 2.3.6 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 8 pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin për kolaudimin e automjetit me targë AB904DB." Shoqëria jone sqaron se: Ne bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e shoqërisë sone, dokumentacioni për mjetin me targë AB904DB është i gjithi i rregullt dhe autoriteti kontraktor duhet të ketë parasysh ndryshimet përkatëse sa i takon ligjit mbi transportin rrugor, ku theksohet se kolaudimi i automjeteve kryhet 1 herë në 2 vjet. Detyrimi ligjor është për pagesën e taksave vjetore të mjetit, cka në të kemi dorëzuar. Çdo dokument i paraqitur për mjetin AB904DB është i vlefshëm sipas legjislacionit në fuqi.

*Sa me sipër arsya e skualifikimit lidhur me këto kriter nuk qendron.*

**4. Referuar pikës 4** "Nuk plotëson pikën 2.1.4 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 8 pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin provues të akreditimit për entin certifikues që ka lëshuar certifikatat ISO 9001 dhe ISO 45001." Shoqëria jone sqaron se:

Certifikatat ISO 9001 dhe ISO 45001 janë të vlefshme dhe të leshuara nga një ent certifikues i akredituar sipas legjislacionit në fuqi. Nëse autoriteti kontraktor do të kishte dyshimi mbi origjinalitetin apo vlefshmerinë e tyre, në certifikatat përkatëse gjenden të gjitha të dhënat e entit certifikues. Autoriteti kontraktor ka patur të gjithë të drejtën për të kontaktuar me entin certifikues në lidhje me vlefshmerinë e tyre apo të na kerkonte dokumentacion shtesë lidhur me këto çështje. Përsakohe nuk ka patur asnjë komunikim si me ne apo me entin certifikues, shoqëria jone garanton që certifikatat janë të vlefshme sipas legjislacionit në fuqi. Autoriteti kontraktor na skualifikon duke theksuar që nuk paraqesim asnjë dokument provues nëderkohe që kriteri është shumë i qartë dhe i mjaftueshëm me paraqitjen e certifikatave përkatëse. Nëse ka dyshime të ndryshme lidhur me këto certifikata, autoriteti kontraktor ka patur të gjithë të drejtën për të kerkua dokumenta provuesë por jo të na skualifikojë apriori pa e provuar këto pike. Bazuar në dokumentat e tenderit nuk ekziston asnjë kriter që e vendos operatorin ekonomik në kushtet duhet të vertetojë me dokumenta shtesë mbi vlefshmerinë e certifikatave ISO.

*Sa me sipër arsya e skualifikimit lidhur me këto kriter nuk qendron.*

*Ndodhur në këto kushte shoqëria jonë kërkon:*

*Rishikimin e arsyeve të skualifikimit si dhe verifikimin e dokumentave të paraqitura nga ana jonë duke kualifikuar ofertën e shoqërisë sonë."*

II.9. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të

procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 2675/2 date 01.11.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes.

II.10. Me anë të shkresës Nr.4278/4 prot., datë 06.11.2023.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr.2675/3 prot., datë 08.11.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “ Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK, sipas të cilit KSHA ka vendosur refuzimin e ankesës, si dhe informacion në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe dokumentat e dorëzuara fizikisht pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK, si operator i renditur në vend të parë.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi me arsyen se”*I. Nuk plotëson pikën 2.3.8 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 8 pasi nuk ka paraqitur skedat teknike për produktet Shkumë AFFF 916 (6%) dhe Dioksid karboni (CO<sub>2</sub>).*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 5 të dokumenteve standarde të tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar:  
**Shtojca 5.**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

#### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh

kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

#### A) Fikse zjarri me pluhur të thatë ABC 40%

Fiksit me pluhur të thatë e pengojnë në mënyre kimike ndezjen dhe mund të quhen ngadalësues universal të zjarreve. Pluhuri i thatë jo vetëm që është efektiv kundër zjarreve të grupit A dhe B, por është i dobishëm për të luftuar edhe zjarret e grupit C.

Fikset e zjarrit me pudër ABC 40%: 6kg, 9 kg, 12 kg, 25 kg, 30 kg dhe 50 kg përdoren për të fikur dhe parandaluar zjarrin i cili mund të jetë shkaktuar nga djegia e:

A-letrave, tekstileve, drurit dhe plastikës.

B- lëndëve djegëse

C- zjarrin e shkaktuar nga paisje elektrike.

Fikja realizohet duke hedhur pudrën rrotull vatrës së zjarrit me qëllim parandalimin dhe eliminimin e zjarrit. Bombola është e ndërtuar nga çelik special sipas standarteve europiane.

<b>FIKSE ZJARRI ME PLUHUR ABC 40%, 6 kg</b>	
Standartet europiane	EN3-3 , EN3-6 , EN3-7
Ngarkesa nominale	6 Kg
Volumi i pajisjes	≈ 6.7litra
Klasa e zjarrit	21A–113B – C
Agjenti fikës	Pluhur ICH- ABC 40%
Temperatura e punës	-30°C +60°C
Tipi i treguesit të presionit	≈ Ø 35
Presioni i provës Ph	≈ 25 Bar
Presioni maksimal i lejuar Ps	≈ 17 Bar
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	9-10 sec
Rrezja e lëshimit	5 - 7 m
Ngjyra	Kuqe

Materiali	Çelik 37.2
Spesori i bombolës	≈ 1.4 mm
Spesori i bazës	≈ 2 mm
Diametri i tubit të gomës	10mm /17 mm
Tipi i valvulës	Me shtypje me gradim
Garancia	1 (një) vit

<b>FIKSE ZJARRI ME PUDËR ABC 40%, 9 kg</b>	
Klasa e zjarrit	A,B,C
Temperatura e punës	-30°C +60°C
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	≈ 17 sec
Rrezja e lëshimit	≈ 7 m
Lartesia	≈ 600 mm
Diametri	≈ 190 mm
Pesha e bomboles pas rimbushjes	≈ 13 kg

<b>FIKSE ZJARRI ME PUDËR ABC 40%, 12 kg</b>	
Klasa e zjarrit	A,B,C
Temperatura e punës	-30°C +60°C
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	≈ 18 sec
Rrezja e lëshimit	≈ 7 m
Lartesia	≈ 660 mm
Diametri	≈ 190 mm
Pesha e bomboles pas rimbushjes	≈ 17.5 kg

<b>FIKSE ZJARRI ME PUDËR ABC 40%, 25 kg</b>	
Klasa e zjarrit	A,B,C
Temperatura e punës	-30°C +60°C
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	≈ 25 sec
Rrezja e lëshimit	≈ 11 m
Lartesia	≈ 1080 mm
Pesha e bomboles pas rimbushjes	≈ 55 kg

<b>FIKSE ZJARRI ME PUDËR ABC 40%, 30 kg</b>	
Klasa e zjarrit	A,B,C
Temperatura e punës	-30°C +60°C
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	≈ 30 sec
Rrezja e lëshimit	≈ 11 m



Lartesia	≈ 1080 mm
Pesha e bomboles pas rimbushjes	≈ 60.84 kg

<b>FIKSE ZJARRI ME PUDËR ABC 40%, 50 kg</b>	
Klasa e zjarrit	A,B,C
Temperatura e punës	-30°C +60°C
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	≈ 49 sec
Rrezja e lëshimit	≈ 12 m
Lartesia	≈ 1050 mm
Diametri	≈ 300 mm
Pesha e bomboles pas rimbushjes	≈ 84 kg

<b>KARAKTERISTIKAT E PLUHURIT</b>		
Subjekti	Karakteristikat	Specifikimet
Përbërja Kimike (%)	Fosfat monoamoniumi 40 Sulfat amoniumi 51	38 – 42 49 – 53
Dëndësia (g/ml)	(g/ml) 0.89	0.82 – 0.96
Analiza e granulimit	Sita 125µm 19 Sita 63µm 45 Sita 40 µm 60	14 - 24 37 – 53 52 – 68
Rezistenca ndaj ngurtësimit	Sita 425µm 0	0
Rezistenca nga uji	Përthithje e ujit Nuk ka	Nuk ka
Përqindja e lagështisë	( % ) <0.25	<0.25

## **B) Fikse zjarri me shkumë AFFF 916**

Fikse zjarri me shkumë dhe përdoret për parandalimin dhe fikjen e zjarrit në prezencën e vajrave dhe yndyrnave.

### **Përshkrimi**

AFFF C6 916 është një koncentrat sintetik me cilësi të lartë sintetike (AFFF) për shuarjen dhe sigurimin e zjarreve nga hidrokarbure të ndezshme.

C6 916 është një kombinim i veçantë i agentëve aktivë hidrokarbure dhe fluorohemik. Materiali përhapet me shpejtësi mbi sipërfaqen dhe hapësiren ku ka zjarr duke siguruar kontroll të shpejtë dhe shuarje të menjëhershme. Krijon formim të shpejtë të shtresës për ndërprerje të shpejtë të flakës dhe shuarje të menjëhershme.

### **Aplikimet**

AFFF C6 916 përdoret në situata me rrezikshmëri të lartë zjarri ku ka përdorim të vajrave, gazit, panele energjie dhe platforma të tjera. Shkuma AFFF C6 916 siguron një shtresë (në formë batanije) të shkumëzuar në vatrën e zjarrit, që paralizon dhe ndërpret në mënyrë të menjëhershme shpërndarjen e vatrës së zjarrit.

### Vetitë fiziko-kimike të shkumës

Fikse zjarri shkumë 6 litra

- Kapaciteti: 6 litra
- Përdorimi: AFFF 3% shkumë
- Temperatura e punës: 0°C deri në 49°C

Temperatura maksimale e ruajtjes së vazhdueshme deri në 49°C

Temperatura maksimale e magazinimit me ndërprerje deri në 60°C

Pika e ngrirjes; -1°C

Efekti i ngrirjes/shkrirjes; Produkti nuk dëmtohet nga ngrirja.

Shkuma që përdoret për mbrojtjen dhe fikjen e zjarrit në prezencën e hidrokarbureve duhet të plotësojë standartet e mbrojtjes sipas ligjeve në fuqi.

<b>FIKSE ZJARRI ME SHKUME AFFF</b>	
Standartet europiane	EN3-7
Ngarkesa nominale	6 Kg
Volumi i pajisjes	≈ 6.7 litra
Klasa e zjarrit	8A-183B klasa 4, përfshin materiale lehtësisht të ndezshme të djegshme; klasa 5, përfshin materiale shumë të ndezshme të djegshme.
Agjenti fikës	Shkumë AFFF 916
Temperatura e punës	-30°C +60°C
Tipi i treguesit të presionit	≈ Ø 35
Presioni i provës Ph	≈ 25 Bar
Presioni maksimal i lejuar Ps	≈ 17 Bar
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	9-10 sec
Rrezja e lëshimit	5 - 7 m

Ngjyra	Kuqe
Materiali	Çelik 37.2
Spesori i bombolës	≈ 1.4 mm
Spesori i bazës	≈ 2 mm
Diametri i tubit të gomës	10mm /17 mm
Tipi i valvulës	Me shtypje me gradim
Garancia	1 (një) vit

### C) Fikse zjarri me CO2

Fikëset e zjarrit me dioksid karboni përdoren vetëm për fikjen e klasave B dhe C të zjarrit, zjarri i lëngshëm (vajrat, yndyrnat) dhe elektrik (aparaturat elektrike).

Fikësit e zjarrit me CO2 fikin zjarret duke zëvendësuar oksigjenin, pa të cilin nuk mund të ketë zjarr, me gazin inert CO2. Gjithashtu dioksidi i karbonit është shumë i ftohtë pasi del nga fikësi, kështu që ftoh edhe karburantin.

Fikja realizohet duke hedhur dioksidin e karbonit rrotull vates së zjarrit me qëllim parandalimin dhe eliminimin e zjarrit, gjithashtu dioksidi i karbonit ndihmon në uljen e temperaturës. Bombula është e ndërtuar nga çelik special sipas standarteve europiane.

<b>FIKSE ZJARRI CO2, 2 kg</b>	
Klasa i zjarrit	≥ 34 B
Ngarkesa nominale	≈ 2 kg
Agenti fikës	CO2 (Dioksid karboni)
Ngjyra	Kuqe
Rrezja e lëshimit	≥ 3 m
Lartësia	580mm ± 20mm
Diametri i jashtëm	102 mm ± 10mm
Temperatura e punës	-20°C +60°C
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	≈ 10 sec
Presioni i shpërthimit	≈ 50 Bar

<b>FIKSE ZJARRI CO<sub>2</sub>, 5 kg</b>	
Klasa i zjarrit	55B-70B
Pesha totale	10-12 kg
Ngarkesa nominale	≈ 5 kg
Agenti fikes	CO <sub>2</sub> (Dioksid karboni)
Ngjyra	Kuqe
Rrezja e lëshimit	3-5m
Lartësia	650-750mm
Diametri i jashtëm	150-160mm
Temperatura e punës	-30°C +60°C
Presioni i shpërthimit	50 Bar-60bar
Garancia	1 (një) vit

**Shënim:** Produkti të pajiset me një shenjë dalluese fosforeshente në trup, kjo për efekt dallimi lehtësisht në errësire.

III.1.2. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8/2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.8., “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**2.3.8** *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/fragmente të katalogut ose skedat teknike të publikuara nën autoritetin e prodhuesit për produktet: Pluhur ABC 40%, Shkumë AFFF 916 (6%) dhe Dioksid Karboni (CO<sub>2</sub>), që do të përdoren në shërbimet që do të kryhen sipas objektivit të prokurimit. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pajisjet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

**Shënim:** Ky kriter (2.3.8) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësisht dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacionit të dhënë nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik “Mbrojtja dhe Shërbimi nga Zjarri” SHPK., në përmbushje të kriterit të mësipërm, ka paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë:

- *Formularin e vetëdeklarimit,*

Në Pjesën III, Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika B Deklaratë“Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kerkohen)” ka deklaruar: *Shoqëria jonë do të paraqesë pranë autoriteti kontraktor katalogët/fragmente të katalogut ose skedat teknike të publikuara nën autoritetin e prodhuesit për produktet: Pluhur ABC 40%, Shkumë AFFF 916 (6%) dhe Dioksid Karboni (CO<sub>2</sub>), që do të përdoren në shërbimet që do të kryhen sipas objektit të prokurimit. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pajisjet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

Ndërsa pranë autoritetit kontraktor, si operator i renditur i pari, ka paraqitur:

- *Katalog GMF-C Makineri Mbushje me pluhur (Instruksione operimi)*
- *Katalog GMD-A Makina Mbushëse Nitrogjen ((Instruksione operimi)*

III.1.4. Neni 2 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” , parashikon shprehimisht se:

*Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.5. Neni 3, “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar*

*artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.6. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

*c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.1.7. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

Ndërsa në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”.



III.1.8. Në nenin 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 2 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet: *“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.10. Në rastin konkret, referuar kriterit 2.3.8 përcaktuar në dokumentet e tenderit, ky kriter konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes fillimisht nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST dhe më pas me dorëzimin e katalogut/fragmente të katalogut ose skedat teknike të publikuara nën autoritetin e prodhuesit për produktet: Pluhur ABC 40%, Shkumë AFFF 916 (6%) dhe Dioksid Karboni (CO<sub>2</sub>). Nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit. KPP konstaton, se në përmbushje të kriterit 2.3.8 të kualifikimit, nga ana e operatorit ekonomik ankimues fillimisht është plotësuar formulari i vetëdeklarimit, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, duke plotësuar kështu kriterin për momentin e parë procedural. Nga ana e operatorit ekonomik ankimues, si operator i renditur në vend të parë, në

përgjigje të kërkesës së autoritetit kontraktor, janë dorëzuar *Katalog GMF-C Makineri Mbushje me pluhur (Instruksione operimi) dhe Katalog GMD-A Makina Mbushëse Nitrogjen ((Instruksione operimi)*. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ankimues, nuk është në përputhje me kriterin e vecantë të kualifikimit 2.3.8 dhe specifikimet teknike të shtojcës 5, pasi nga ana e tij janë paraqitur katalog (instruksione operimi) për makineritë dhe jo katalog/fragmente katalogu apo skedë teknike për produktet *Pluhur ABC 40%, Shkumë AFFF 916 (6%) dhe Dioksid Karboni (CO<sub>2</sub>)*.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret e veçanta të kualifikimit apo edhe specifikimet teknike, duhet të përmbushen nga të gjithë operatorët ekonomikë pjesmarrës në procedurë për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri apo specifikimi të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat standarte të tenderit në shërbim të realizimit të kontratës e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, ankimuesi me dokumentacionin e paraqitur nuk provon përmbushjen e kriterit 2.3.8 të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Mbrotjtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi me arsyen se” **2. Nuk plotëson kërkesat e Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit Pika 1 Paragrafi 2, pasi skeda teknike e produktit pluhur ABC (40%) është paraqitur në gjuhë të huaj e papërkthyer**”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8, “Formulari i Kriterëve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit” autoriteti kontraktor ka përcaktuar :

### **1.KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda

Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

III.2.2. Në shtojcën 8/2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.8., “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/fragmente të katalogut ose skedat teknike të publikuara nën autoritetin e prodhuesit për produktet: Pluhur ABC 40%, Shkumë AFFF 916 (6%) dhe Dioksid Karboni (CO<sub>2</sub>), që do të përdoren në shërbimet që do të kryhen sipas objektit të prokurimit. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pajisjet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.**

***Shënim:*** Ky kriter (2.3.8) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacionit të dhënë nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik “Mbrojtja dhe Shërbimi nga Zjarri” SHPK., në përmbushje të kriterit të mësipërm, ka paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin e vetëdeklarimit,

Ku në Pjesën III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kerkohen)” ka deklaruar: *Shoqëria jonë do të paraqesë pranë autoriteti kontraktor katalogët/fragmente të katalogut ose skedat teknike të publikuara nën autoritetin e prodhuesit për produktet: Pluhur ABC 40%, Shkumë AFFF 916 (6%) dhe Dioksid Karboni (CO<sub>2</sub>), që do të përdoren në shërbimet që do të kryhen sipas objektit të prokurimit. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pajisjet e*

*përzgjedhura, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

Ndërsa pranë autoritetit kontraktor, si operator i renditur i pari, ka paraqitur:

- *Skedën teknike për produktin pluhur ABC (FUREX ABC 40 ) në gjuhën angleze*

III.2.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të*

*njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

*Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

*III.2.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*

*Ndërsa në nenin 24 “Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët” , pika 1 dhe 2 të po këtij vendimi parashikohet:*

*1. Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e ofertës, nga pjesëmarrësit bazuar në dokumentet standarde të tenderit.*

*2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe.*

*Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme,*

*mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.*

III.2.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme.

Duke u kthyer në rastin objekt gjykimi, KPP konstaton se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet se ofertuesit do të sigurojnë furnizimin me **Pluhur ABC 40%**, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në përmbushje të kësaj kërke, autoriteti kontraktor ka përcaktuar fillimisht paraqitjen e formularit të deklaramit e më pas operatori ekonomik i rendituri pari duhet të paraqesë katalog/fragmenteve të katalogut apo skedën teknike të publikuar nën autoritetin e prodhuesit për këtë produkt, në mënyrë që të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit apo jo. Në kushtet kur vlera e kontratës së shpallur është nën kufirin e ulët monetar, autoriteti kontraktor në pikën 1, paragrafi 2 të “Kritereve të përgjithëshme të kualifikimit” ka përcaktuar si gjuhë të përgatitjes së ofertave gjuhën shqipe, çka nënkupton se dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë në gjuhën shqipe. KPP konstaton se, nga ana e operatorit ekonomik ankimues në përmbushje të këtij kriteri është dorëzuar fillimisht formulari i deklaramit dhe më pas, mbi kërkesën e autoritetit kontraktor, nga ana e operatorit ekonomik ankimues, si operator i renditur në vend të parë, është paraqitur skeda teknike për produktin objekt prokurimi (FUREX ABC 40) Nga verifikimi i këtij dokumenti, KPP gjykon se ky dokument nuk është paraqitur në gjuhën shqipe, sikurse është edhe gjuha e përdorur për procedurën e prokurimit objekt ankimi, e për rrjedhojë nuk mund të gjykojë nëse specifikimet e paraqitura në këtë skedë teknike janë konform specifikimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin **Pluhur ABC 40%**. Për rrjedhojë, KPP vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” për produktin **Pluhur ABC 40%**, nuk është në përputhje me kërkesat e Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit Pika 1 Paragrafi 2, duke mos plotësuar kriterin 2.3.8, në funksion të të cilit është paraqitur.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi me arsyen se” 3. *Nuk plotëson pikën 2.3.6 të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 8 pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin për kolaudimin e automjetit me targë AB 904 DB”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.3.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8/2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.6., “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qira të paktën 1 (një) automjet ATP (automjet i transportit të përzier) për realizimin në kohë të shërbimeve objekt të prokurimit. Për këtë duhet të paraqesë, (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin dhe Kolaudimin) të vlefshme, ose në rast se nuk e ka automjetin në pronësi të paraqesë kontratën e qirasë për një afat sa kohëzgjatja e kontratës së parashikuar si dhe dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e automjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin dhe Kolaudimin) të vlefshme.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësisimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

III.3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacionit të dhënë nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik “Mbrotjtja dhe Shërbimi nga Zjarri” SHPK., në përmbushje të kriterit të mësipërm, ka paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë:

- *Formularin e vetëdeklarimit,*

Në Pjesën III, Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika B, Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kerkohen)” ka deklaruar: *Makineri e mjete Po*

*1.Volkswagen, targa AA807VA, Tip autolaborator dhe te gjitha makinerite per mbushjen me CO2, mbushjen me pluhur dhe për mbushjen me shkumë. Të gjitha këto vertetohen me dokumenta qe do ti paraqesë ne rast te rezultatit fitues.*

*2.Mercedes benz, targa AB 904 DP, tip ATP*

Ndërsa, pranë autoritetit kontraktor si operator i renditur i pari, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri ka dorëzuar :

*-Lejen e qarkullimit për mjetin me targa AB 904 DP*

*-Certifikaten e pronësisë së mjetit me targa AB904DP, në emër të operatorit ekonomik “Mbrotjtja dhe Shërbimi nga Zjarri” SHPK*

*-Siguracionin e mjetit me targa AB 904 DP*

*-Taksat vjetore te mjetit me targa AB 904 DP*



III.3.3. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.3.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*a)operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

*d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.3.5.Neni 79, pikat 1,2 e 3 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikon shprehimisht: “1. Ministri, që mbulon veprimtarinë përkatëse, përcakton, me urdhër dhe udhëzim të veçantë, kriteret, kohën dhe mënyrat e kryerjes së kontrollit teknik të kategorive të mjeteve me motor dhe të rimorkiove, për të garantuar sigurinë dhe qetësinë në qarkullim dhe se ndotja e shkaktuar prej tyre nuk i kalon kufijtë e përcaktuar. Kontrollat teknike kryhen në qendrat e kontrollit teknik, të licencuara nga ministria, që mbulon veprimtarinë përkatëse, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet në fuqi. Në udhëzim përcaktohen elementet, për të cilat duhet të kryhet kontrolli teknik i sistemeve të mjeteve, që kanë rëndësi për sigurinë e tyre.

Prodhuesit dhe përfaqësuesit e tyre u transmetojnë qendrave të kontrollit teknik informacion për sistemet dhe pajisjet e mjeteve për të cilat kryhet kontrolli teknik në mënyrë të vazhdueshme, në kohë, pa kufizim, me qasje të lehtë dhe jodiskriminuese. Informacioni vihet në dispozicion 6 muaj pas regjistrimit të mjetit.

Bëjnë përjashtim rastet e parashikuara në pikat 6 dhe 8 të këtij neni për të cilat informacioni transmetohet sipas kërkesës dhe pa vonesa.

2. Përmbajtja e udhëzimeve të nxjerra në zbatim të pikës 1 t’iu referohet direktivave të Komunitetit Europian, në lidhje me kontrollin teknik të mjeteve motorike.

3. Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të detyruara të kalojnë në kontroll teknik. Për mjetet e reja me motor kontrolli teknik do të kryhet brenda tre vjetëve nga data e regjistrimit të parë. Pas kësaj periudhe ky kontroll kryhet për çdo dy vjet. Mjetet e kategorisë M1, të përdorura si taksi dhe ambulanca, si dhe mjetet e kategorive M2, M3, N2, N3, O3, dhe O4 kryejnë kontroll teknik çdo vit. Mjetet e reja të kategorisë M1, të përdorura si taksi dhe ambulanca, si dhe mjetet e kategorive M2, M3, N2, N3, O3 dhe O4 kryejnë kontroll teknik brenda një viti nga data e regjistrimit të parë dhe më pas çdo vit”

III.3.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të

papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.3.6. Në rastin konkret, referuar kriterit 2.3.6 përcaktuar në dokumentet e tenderit, ky kriter konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimin dhe paraqitjes fillimisht nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST dhe më pas me dorëzimin e dokumentacionit provues nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit. KPP konstaton, se në përmbushje të kriterit 2.3.6 të kualifikimit, nga ana e operatorit ekonomik ankimes fillimisht është plotësuar formulari i vetëdeklarimit, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, duke plotësuar kështu kriterin për momentin e parë procedural. Nga ana e operatorit ekonomik ankimes, si operator i renditur në vend të parë, në përgjigje të kërkesës së autoritetit kontraktor, janë dorëzuar dokumentat për mjetin me targa AB 904 DP, të shprehura në pikën III.3.2 të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, Komisioni i Prokurimit Publik, në dokumentin Leje e qarkullimit të mjetit me targa AB 904 DP, në rubrikën Kontrolli teknik, konstaton se kontrolli i fundit teknik është kryer në datën 15.09.2021. Referuar nenit 79 të Kodit Rrugor ky kontroll është i vlefshëm për dy vjet, pra deri në datën 15.09.2023. Hapja e ofertave për procedurën e prokurimit objekt ankimi është bërë në datën 22.09.2023, pra pas përfundimit të afatit të vlefshmërtisë së aktit të kontrollit për mjetin e paraqitur nga ankimesi, mjetin me targa AB 904 DP. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, KPP nuk konstaton ndonjë dokument tjetër në funksion të përmbushjes së këtij kriteri kualifikimi, duke mospërmbushur kështu të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në pikën 2.3.6. të kriteve të veçanta të kualifikimit.

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri apo specifikimi të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet standarde të tenderit e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor. Referuar sa më sipër, kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.6 të dokumenteve të tenderit vlerësohet i papërmbushur nga operatorit ekonomik ankimes

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.4. Marrë shkas nga pretendimet e operatorit ekonomik “ Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK, nga verifikimi i kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilave është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se një prej kriterëve është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe, konkretisht.

III.4.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi me arsyen se “4.Nuk plotëson pikën 2.1.4 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 8 pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin provues të akreditimit për entin çertifikues që ka lëshuar çertifikatat ISO 9001 dhe ISO 45001”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.2. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8/2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.1.4., “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**2.1.4** *Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.*

**Shënim:** *Ky kriter (2.1.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

III.4.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- *Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit i plotësuar nga operatori ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK.*

III.4.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*

c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 e 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik....*

*2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës”*

III.4.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*



*ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

*d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

*dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

*e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

*ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

*f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

*g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

*gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

*h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);*

*i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*

*j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;*

*k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

*3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

*4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

*5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.4.6. Në nenin 41, pika 2 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.4.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

KPP konstaton, se duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimes ka të bëjë me skualifikimin e tij për mospërmbushje të kriterit kualifikues 2.1.4 të shtojcës 8 të dokumentave të tenderit. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në hartimin e kriterëve në çdo rast

duhet të ketë parasysh elemente të tilla si transparenca, besimi publik, dobishmërinë dhe nevojën që dikton vendosjen e kërkesës. Në rastin konkret, KPP vlerëson, se përcaktimi i bërë nga autoriteti kontraktor për kriterin 2.1.4 *“Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë”*, është një përcaktim i cili nuk gjen mbështetje në aktet ligjore/nënligjore në fuqi. KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë paraqitjen e dokumentave për subjekte që nuk janë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Në rastin objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor mund të kryente verifikime për çertifikatat e konformitetit të dorëzuara nga ofertuesit, ose të kërkonte nga operatorët ekonomikë sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, sikurse përcaktohet në nenin 82/2 të LPP e nenin 26/7 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, por kurrësi të kërkonte nga ofertuesit paraqitjen e dokumentit që do të provonte se, autoriteti/subjekti i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave të kërkuara për ofertuesit, *ISO 9001 dhe ISO 45001*, është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar një kriter i cili bie ndesh me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Për rrjedhojë, nuk mund të garantohet një mjet ankimi efektiv në lidhje me pretendimin e mësipërm të ankimuesit, pasi KPP nuk mund të shprehet mbi themelin e kërkesave, duke qenë se kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.1.4. të dokumentave të tenderit është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik . Komisioni i Prokurimit Publik KPP thekson, se kriteret e kualifikimit si dhe specifikimet teknike duhet të përcaktohen jo vetëm të qarta dhe të sakta nga autoriteti kontraktor, por edhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

III.4.8. Sa më sipër, bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”*, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, ku parashikohet se: *“[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë*

*plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.1.4. të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit, nuk është në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik. Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vlerësuar mbi kritere jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit.*

Sa më lart, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Mbrotjtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-79555-09-11-2023 me objekt “Shërbim për rimbushjen dhe kolaudimin e pajisjeve kundër zjarrit”, (marrëveshje kuadër), me fond limit 7,497,514 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.09-2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Pergjithshme e Objekteve Publike Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Mbrotjtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**